STATE OF NEW YORK | EXECUTIVE CHAMBER

ANDREW M. CUOMO | GOVERNOR

Për Njoftim të Menjëhershëm: 24 maj 2013

GUVERNATORI KUOMO (CUOMO) NJOFTON FUSHATEN PER TE NXITUR TURIZMIN NE ZONAT E LONG AJLEND (LONG ISLAND) QE PO RIMEKEMBEN NGA SENDI (SANDY)

Fushata e nxitjes me Hekurudhën e Long Ajlënd MTA (MTA Long Island Rail Road), Qytezën e Long Biç (City of Long Beach) dhe bizneset vendase për të rritur turizmin dhe rimëkëmbjen në vazhdim nga Sendi (Sandy)

Paketa e LIRR Long Biç (LIRR Long Beach) ofron zbritje prej 26% të tarifave të trenave dhe pranimeve në plazh plus zbritje nga tregtarë vendas

Guvernatori Endju M. Kuomo (Andrew M. Cuomo) njoftoi sot një fushatë për të nxitur turizmin për bizneset dhe komunitetet e Long Ajlënd (Long Island) që u prekën nga super stuhia Sendi (Sandy). Guvernatori ka organizuar një partneritet ndërmjet Hekurudhës së Long Ajlënd MTA (MTA Long Island Rail Road) dhe Qytezës së Long Biç (City of Long Beach) me biznese vendase në fushatën e nxitjes për të rritur sezonin turistik të verës të rajonit. Njoftimi vjen disa javë pasi Guvernatori mblodhi takimin e nivelit të lartë të parë ndonjëherë të turizmit të Nju Jorkut (New York) me udhëheqës të industrisë dhe pronarë të bizneseve për të identifikuar mënyra për të çuar përpara dhe për të shfrytëzuar pasuritë e konsiderueshme turistike të shtetit.

"Dëshirojmë që të gjithë të dinë se, pavarësisht nga dëmi me të cilin u përballëm nga super stuhia Sendi (Sandy), destinacionet e verës të Long Ajlënd (Long Island) janë rikthyer dhe janë më të mira sesa kurrë më parë," tha Guvernatori Kuomo (Cuomo). "Shteti i Nju Jorkut (New York State) ka pasuri të pashembullta kur bëhet fjalë për turizmin dhe dëshirojmë t'i shfrytëzojmë ato plotësisht për të ndihmuar zonat e Long Ajlënd (Long Island) që janë ende duke u rimëkëmbur nga Sendi (Sandy). Kjo paketë e LIRR Long Biç (LIRR Long Beach) është një mundësi e mirë për Long Ajlënd (Long Island) dhe një tërheqje e shkëlqyeshme për turistët e Nju Jorkut (New York)."

Paketa e LIRR Long Biç (LIRR Long Beach) tani do të përfshijë zbritje të shumta nga tregtarët si dhe mundësinë për të udhëtuar falas në autobusat dhe trolejbusat e Long Biç (Long Beach) që funksionojnë në pjesën perëndimore të qytetit. Paketa ofron gjithashtu një zbritje prej 26% nga kosto e zakonshme e tarifës së trenit dhe pranimit në plazh. Mbi 58,000 paketa të Long Biç (Long Beach) u shitën më 2012, duke arritur në më shumë se gjysmë milionë dollarë në të ardhura për qytetin.

Presidentja e LIRR-t Helena E. Uilliams (Helena E. Williams) tha, “Long Biç (Long Beach) është një nga destinacionet me të admiruara të plazhit të Hekurudhës së Long Ajlënd (Long Island Rail Road). E dimë sa i rëndësishëm do të jetë ky sezon turistik si pjesë e procesit të rimëkëmbjes nga Sendi (Sandy) dhe prandaj jemi të gëzuar të bëjnë partneritet me Qytezën e Long Biç (City of Long Beach) për t’u ofruar udhëtarëve të LIRR-t vlera shtesë, përfshirë zbritje nga tregtarët dhe transporte me autobus përreth Long Biç (Long Beach).”

Zyrtari i Qarkut Naso (Nassau County) Ed Mangano tha, “Me ndihmën e Guvernatorit Kuomo (Cuomo), destinacionet tona të verës janë kthyer në punë pas dëmit nga urgani Sendi (Sandy). Ftoj të gjithë të vijnë në Qarkun Naso (Nassau County) për të shijuar plazhet, pishinat, fushat e golfit dhe fshatrat në qendër të qytetit tonë.”

Presidenti i Këshillit të Qytezës së Long Biç (Long Beach City Council) Skot J. Mandel (Scott J. Mandel) tha, “Mirëpresim gjithkënd të bashkohen me ne këtë verë në plazh, në restorantet dhe dyqanet tona dhe në koncertet e festivalet tona. Long Biç (Long Beach) është i hapur për punë. Me të vërtetë do të kemi një sezon veror të jashtëzakonshëm.”

Qyteza e Long Biç (City of Long Beach) pësoi dëm të rëndë të pronave publike dhe private kur super stuhia Sendi (Sandy) goditi tetorin e kaluar. Tonelata rëre u frynë nga plazhet dhe rruga me bordura të famshme të Qytezës – e cila po rindërtohet tani – u shkatërrua. Shumë në qytezën me 33,000 vetë panë dëmtime ose shkatërrime të shtëpive të tyre. Stuhia gjithashtu dëmtoi qindra makina dhe ndoti ujin e pijshëm për disa ditë.

Hekurudha e Long Ajlënd (Long Island Rail Road) pësoi dëmin më të rëndë nga Sendi (Sandy) në zonën e Long Biç (Long Beach), me nënstacione elektrike të nxjerra jashtë pune dhe shërbimin të ndërprerë në jug të Linbruk (Lynbrook) për pothuajse dy javë. Shërbimi në Degën e Long Biç (Long Beach) u rivendos më 14 nëntor 2012 me shërbimin çdo orë me naftë dhe më 26 nëntor 2012 me shërbim elektrike duke rilidhur udhëtarët plotësisht me vendet e tyre të punës në Qytetin e Nju Jorktu (New York City), shenja më e qartë se rimëkëmbja ishte në vazhdim. Muajin e kaluar, Long Biç (Long Beach) nisi zyrtarisht fillimin e rindërtimit të rrugës së saj me bordura 2 milje të gjatë.

Qyteti është gati të investojë deri në 44 milionë dollarë në rrugën e re me bordura me pjesë që do të hapet për publikun gjatë verës. Megjithëse projekti nuk do të përfundojë plotësisht deri në nëntor, mundësia e përdorimit të plazhit dhe oqeanit nuk është prekur.

Me atë në mendje, LIRR dhe qyteti kanë krijuar një paketë që do t’u lejojë udhëtarëve të LIRR që udhëtojnë nga Manhatan (Manhattan) dhe Bruklin (Brooklyn) të blejnë një biletë vajtje-ardhje, pranimin në plazh, shërbimin e autobusave ose trolejbusave në të gjithë ishullin dhe zbritje të tregtarëve për 22 dollarë, një kursim prej 26%. Për ata që udhëtojnë nga Xhamejka Stejshëm (Jamaica Station), paketa do të kushtojë vetëm 18.75 dollarë.

Albanian

Deri tani, mbi 20 tregtarë janë rregjistruar për të ofruar zbritje për mbajtësit e paketave të Long Biç (Long Beach):

C & C Deli Corp.	10% zbritje për 25 dollarë e sipër; 5% zbritje për 25 dollarë e poshtë
Long Beach Plaza Liquor	20% zbritje për blerjet e verës; 10% zbritje për blerjet e alkoolit
Tutti Frutti	10% zbritje për blerjet e kosit
Lido Kosher Deli	10% zbritje (jo e vlefshme me oferta të tjera)
Villaggio Ristorante	10% zbritje nga e gjithë shuma për vaktet e ngrëna në restorant ose të mara me vete
West End Pizza	15% zbritje
Life's A Bagel	Shishe uji 16oz. Polan Spring falas me blerje tjetër
Newtown Chinese Restaurants	10% zbritje minimumi 15 dollarë, duke të paraqesësh kupona, dreka speciale nuk përfshihen
Sutton Place American Bar & Grill	10% zbritje nga e gjithë shuma, gjithashtu pije speciale çdo ditë bashkë me drekat special
Red Mango Long Beach	1.00 zbritje për çdo artikull të menusë
Citibank	Çantë mirëpritje me një dhuratë
Gentle Brew Coffee Roasters	10% zbritje për çdo pije në menu
Beach Liquors	20% zbritje për shitjet e verës; 10% zbritje për shitjet e alkoolit
Abe's Pitaria	10% zbritje për blerjet
Ooh La La	10% zbritje për blerjet në dyqan për vizitorët me kupon
Skudin Surf	10% zbritje

Laurel Luncheonette	10% zbritje nga e gjithë shuma në çdo kohë vetëm për ushqime dhe pije, nuk mund të kombinohet me oferta të tjera
Max Bialystok & Company	10% zbritje për porosi, përveç festave
Rose & Eye	15% zbritje nga të gjitha blerjet
Billy's Beach Café	$10 zbritje nga çdo blerje prej 30 dollarë ose më shumë
Sugo	Ora e gëzuar 4-7 pasdite, bli një merr një koktej falas, pjata të vogla me gjysmë çmimi
King's Pharmacy West	10% zbritje
Long Beach Craft and Value	Balonë falas me çdo blerje të karriges dhe çadrës së plazhit

Bizneset e interesuara që të bashkohen me Paketën e LIRR të Long Biç (LIRR Long Beach) duhet të kontaktojnë Qytezën e Long Biç (City of Long Beach).

Udhëtarët mund t'a blejnë paketën e LIRR Long Biç (LIRR Long Beach) në çdo zyrë të hapur të biletave ose në një makinë të shitjes së biletave të LIRR.

Për më shumë informacion, vizitoni http://www.mta.info/lirr/getaways/beach/LongBeach.htm.

###

Lajme të tjera të disponueshme në www.governor.ny.gov
Shtetit të Nju Jorkut | Executive Chamber | press.office@exec.ny.gov | 518.474.8418